



Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, takohet me misionin e Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar, i përbërë nga përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore

Vijon në faqen 2

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me 23 rregullatorë të tregjeve të Letrave me Vlerë në Evropë

Vijon në faqen 2



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-qershor 2013

Vijon në faqen 3

Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2013

Vijon në faqen 4

ZHVILLIME TË TJERA

AMF organizon trajnimin lidhur me sistemin e raportimit elektronik AMF In-Reg, për veprimtarinë në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë (16 korrik 2013)

Vijon në faqen 6

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, takohet me Zëvendësguvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës (17 korrik 2013)

Vijon në faqen 7

Seminar ndërkombëtar mbi çështjet thelbësore të mbikëqyrjes së sigurimeve (14-19 korrik 2013)

Vijon në faqen 7

LAJMET NGA RAJONI

Forumi AIIF - Azerbajxhan

Vijon në faqen 8

Abu Dhabi

Vijon në faqen 9

Turqi

Vijon në faqen 10

Lituani

Vijon në faqen 10

Sllovaki

Vijon në faqen 11

AMF do të plotësojë disa pyetësorë të detajuar në lidhje me tregjet financiare të mbikëqyrura dhe më tej do t'i kalojë për vlerësim, i cili është planifikuar paraprakisht në periudhën tetor-nëntor 2013

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, takohet me misionin e Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP), i përbërë nga përfaqësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB)

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Znj. Enkeleda Shehi, priti në datën 18 korrik përfaqësues të Bankës Botërore (BB) dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), në kuadrin e Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP).

Programi i Vlerësimit të Sektorit Financiar, përfshin analizën e plotë mbi stabilitetin e sektorit financiar në vend dhe mbi nevojat e mëtejshme të zhvillimit. Vlerësimi i fundit i kryer për Shqipërinë në kuadër të këtij programi, është i vitit 2005 dhe ky mision ka për qëllim përditësimin e vlerësimit të mëparshëm.

Gjatë takimit u bë një prezantim nga ana e misionit planifikues të FSAP-së në lidhje me organizimin dhe shtrirjen e procesit, si dhe pikat ku kërkohet angazhim i AMF-së. Në fazën e parë të procesit AMF duhet të plotësojë disa pyetësorë të detajuar në lidhje me tregjet financiare të mbikëqyrura dhe më tej t'i kalojë për vlerësim, i cili është planifikuar paraprakisht në periudhën tetor-nëntor 2013.

Kryetarja e AMF-së, Znj. Shehi, bëri një panoramë të qartë të zhvillimeve të fundit në tregjet financiare të mbikëqyrura nga AMF dhe sfidat aktuale me të cilat ky institucion po përballet, veçanërisht për forcimin dhe mbrojtjen e pavarësisë së autoritetit rregullator dhe të forcimit të kapaciteteve administrative për t'iu përgjigjur zhvillimeve të tregut financiar dhe mbikëqyrur me efektivitet atë.

Në përfundim të procesit Fondi Monetar Ndërkombëtar do të paraqesë konkluzionet e tij në një raport të quajtur Vlerësimi i Stabilitetit të Sektorit Financiar (FSSA).

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me 23 rregullatorë të tregjeve të Letrave me Vlerë në Evropë

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me 23 organizma rregullatorë evropianë që veprojnë në tregjet e letrave me vlerë dhe më specifikisht për fondet alternative të investimeve. Nënshkrimi i këtyre marrëveshjeve u koordinua nga Autoriteti Evropian i Tregjeve dhe Letrave me Vlerë (European Security and Market Authority, ESMA) në zbatim të direktivave të Bashkimit Evropian dhe ka hyrë në fuqi në datën 22 korrik 2013.

Marrëveshjet bilaterale me secilin nga rregullatorët homologë synojnë bashkëpunimin për konsultime, shkëmbim të informacionit lidhur me mbikëqyrjen e Subjekteve Administruese të Fondeve Alternative të Investimeve. Nëpërmjet tyre autoritetet shprehin vullnetin e tyre për një bashkëpunim në përmbushje të mandateve të tyre rregullatore, duke përfshirë mbrojtjen e investitorëve, ruajtjen e integritetit dhe zhvillimin e besimit në tregjet e kapitaleve si edhe reduktimin e risqeve sistematike. Marrëveshjet janë të lidhura me Direktivën e Bashkimit Evropian (EU Directive 2011/61/EU) të datës 8 qershor 2011, për subjektet Administruese të Fondeve Alternative të Investimeve (AIFMD). Ato gjithashtu përcaktojnë qëllimin e bashkëpunimeve, procedurat që ndiqen në rastin e vizitave ndërkufitare, rregullat e konfidencialitetit për informacionin, etj.

Edhe pse në Shqipëri aktivitetet e këtyre fondeve janë ende të pazhvilluara, nënshkrimi i marrëveshjeve konsiderohet si një hap i rëndësishëm në rritjen e bashkëpunimit mbikëqyrës midis AMF-së dhe vendeve anëtare të EU-së.

Pas një procesi të gjatë konsultimesh me vendet anëtare dhe jo-anëtare të EU-së, duke i bërë të dedikuar në terma të njëjta bashkëpunuese këto vende, Shqipëria e ka nënshkruar marrëveshjen me autoritetet homologe të vendeve si: Britania e Madhe, Bullgaria, Danimarka, Estonia, Finlanda, Greqia, Holanda, Hungaria, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Irlanda, Malta, Polonia, Portugalia, Qipro, Republika Çeke, Republika e Sllovakisë, Rumania e Suedia, si edhe 3 mbikëqyrës të letrave me vlerë të Hapësirës Ekonomike Evropiane (EEA) Islanda, Norvegjia dhe Lihtenshteini.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-qershor 2013

Tregu i sigurimeve u ul me 2.45% në janar-qershor 2013. Vlera e primit të shkruar bruto në 6-mujorin e parë të vitit arriti në 3.95 miliardë lekë, ndërsa numri i policave të sigurimit pati një ulje me 3.49% dhe arriti në 453,288 polica sigurimi.

Sigurimi Jo-Jetës u ul me 4.94% në janar-qershor 2013 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa sigurimi i Jetës u rrit me 15.10% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Ndërkohë, dëmet e paguara bruto regjistruan një ulje me 8.93% në krahasim me periudhën janar-qershor 2012.

Sigurimi i detyrueshëm motorik


Sigurimi i detyrueshëm për periudhën janar-qershor 2013 përbën 42.90% të tregut të sigurimeve të Jo-Jetës. Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën 1.68 miliardë lekë, me një ulje prej 8.95% krahasuar me janar-qershor 2012.

—
Sigurimi i Jetës u rrit me 15.10% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar
—

Jo-Jeta, të tjera

Klasa të tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës përbëhen nga *zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë*, të cilat zunë 22.13% të tregut të Jo-Jetës. Klasat, sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësisë të përgjithshme, së bashku zunë 15.98% të tregut të Jo-Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-qershor 2013



Zhvillimet e tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-qershor 2013


Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2013 u dominua në masën 55.85% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (*bono thesari*) dhe pjesa tjetër prej 44.15% ishin instrumente afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 97.45% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-qershor 2013 flasin për një dominim të transaksioneve “*Blerje në tregun primar*” dhe “*Shlyerje e vlerës nominale në maturim*” përkatësisht me 62.70% dhe 23.48% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 98.06% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Krahasuar me periudhën janar-qershor 2012, vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 846 milionë lekë.

Letra me Vlerë të Qeverisë, janar-qershor 2013



*

A - Blerje në tregun primar

B - Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar

C - Blerje nga individët para afatit të maturimit

D - Vendosi e bonos si kolateral

E - Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit **B** “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-qershor 2013, ka pasur një ulje prej 1,053 milionë lekë ose 27.62%, krahasuar me periudhën janar-qershor 2012. Po kështu është ulur numri i transaksioneve në masën 13.47%.

Transaksioni i llojit **C** “Blerje nga individët para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-qershor 2013 ka pasur një rritje prej 207 milionë lekë ose 15.84% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012. Gjithashtu numri i transaksioneve është rritur në masën 24.17%.

Krahasuar me periudhën janar-qershor 2012, vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 846 milionë lekë.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë, janar-qershor 2013

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale (në mln lekë)	Ndryshimi (në %)		
janar-qershor		2012	2013	2013/2012
Letra me Vlerë të Qeverisë				
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	3,813.24	2,760.14	(27.62)
	Individë	2,796.77	2,714.98	(2.92)
	Persona juridikë	1,016.47	45.16	(95.56)
C	Blerje nga individët para afatit të maturimit	1,308.42	1,515.69	15.84
	Individë	766.37	1,315.69	71.68
	Persona juridikë	542.05	200.00	(63.10)

ZHVILLIME TË TJERA

AMF organizon trajnimin lidhur me sistemin e raportimit elektronik AMF In-Reg, për veprimtarinë në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë

(16 korrik 2013)

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi me 16 korrik trajnimin për përdorimin e sistemit të raportimit elektronik, AMF In-Reg, për subjektet e licencuara që ushtrojnë veprimtari në Tregun me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë.



Trajnimi mbi sistemin e raportimit elektronik AMF In-Reg, për veprimtarinë në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë

Sistemi AMF In-Reg ka qenë një ndër nismat dhe objektivat afatmesëm më të rëndësishëm të viteve të fundit, i mbështetur nga BERZH, dhe pas një pune 5 vjeçare, që prej vitit 2012 është në funksion të plotë për tregun e sigurimeve. Shtrirja e kësaj platforme moderne raportimi edhe për segmentet e tjera të tregjeve financiare që AMF mbikëqyr ka qenë pjesë e strategjisë së AMF-së, që në konceptimin e këtij sistemi.

Pjesëmarrës në trajnim ishin përfaqësues nga “Raiffeisen Bank” sh.a., “Intesa SanPaolo Bank” sh.a., “Banka Kombëtare Tregtare” sh.a., “Alfa Bank Albania” sh.a., “Banka Credins” sh.a., “Tirana Bank” sh.a., “First Investment Bank” sh.a., “Banka Societe Generale Albania” sh.a. dhe “Posta Shqiptare” sh.a.

Sistemi elektronik i raportimit AMF In-Reg synon informatizimin e procesit të raportimit në tregun me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë, duke rritur efektivitetin dhe duke garantuar siguri dhe besueshmëri në analizën e tyre. Formatet e raportimit elektronik për aktivitetin në tregun e Letrave me Vlerë të Qeverisë do të jenë në proces testimi si nga subjektet ashtu edhe nga AMF deri në dhjetor 2013 për të kaluar më pas në zbatim të plotë.

Gjatë trajnimit, ekspertët e AMF-së demonstruan hapat konkretë dhe etapat e raportimit elektronik, duke shpjeguar edhe detajet e ndryshme, si dhe duke ju përgjigjur pyetjeve për këtë sistem. AMF ka hartuar edhe një manual përdorimi, i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit, për të realizuar një funksionim sa më të mirë të sistemit.

Formatet e raportimit elektronik për aktivitetin në tregun e Letrave me Vlerë të Qeverisë do të jenë në proces testimi si nga subjektet ashtu edhe nga AMF deri në dhjetor 2013 për të kaluar më pas në zbatim të plotë.

Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, takohet me Zëvendësguvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës

(17 korrik 2013)

Në kuadër të bashkëpunimit midis Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF) dhe Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), një delegacion nga kjo bankë bëri një vizitë pune në datën 17 korrik 2013, pranë zyrave të AMF-së. Delegacioni kryesohej nga zëvendësguvernatori i BQK, Z. Nexhat Kryeziu.

Takimi lidhej me diskutimin e disa çështjeve specifike për tregun e sigurimeve dhe byrotë e sigurimeve përkatëse, në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit të nënshkruar në vitin 2008 nga të dy institucionet, si dhe në vazhdimësinë dhe forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis dy institucioneve, në drejtim të mbikëqyrjes dhe rregullimit të tregjeve respektive.

Kryetarja e Autoritetit Znj. Enkeleđa Shehi shprehu kënaqësinë që takime të tilla të përbashkëta i japin një nxitje më të madhe bashkëpunimit midis institucioneve, shkëmbimit të informacionit dhe përvojave teknike dhe profesionale.

Si Kryetarja e AMF-së Znj. Shehi ashtu edhe zëvendësguvernatori i BQK, Z. Kryeziu theksuan mundësinë dhe nevojën e organizimit të takimeve më të gjera rajonale për të diskutuar për strategji dhe projekte të përbashkëta për zhvillim të mëtejshëm.

Seminar ndërkombëtar mbi çështjet thelbësore të mbikëqyrjes së sigurimeve

(14-19 korrik 2013)

Instituti për Stabilitet Financiar (*Financial Stability Institute, FSI*), zhvilloi gjatë periudhës 14-19 korrik, në Beatenberg, Zvicër, seminarin e 9-të ndërkombëtar mbi çështjet thelbësore të mbikëqyrjes së sigurimeve. Në këtë seminar të përvitshëm morën pjesë 19 përfaqësues nga shtete të ndryshme të botës. Seminari u zhvillua në formën e një tryeze të rrumbullakët, me diskutime në grup, duke synuar shkëmbimin e ideve e këndvështrimeve të ndryshme lidhur me mbikëqyrjen në sigurime. Disa nga temat kryesore që u trajtuan në këtë seminar ishin:



Pjesëmarrës të seminarit gjatë diskutimeve në grupe pune

Në takim u diskutuan çështje specifike për tregun e sigurimeve dhe byrotë e sigurimeve përkatëse, në kuadër të Marrëveshjes së Mirëkuptimit, nënshkruar në 2008 nga dy institucionet

1. Roli i Shoqatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (*International Organization of Insurers Supervisors, IAIS*) dhe i standardeve ndërkombëtare;
2. Menaxhimi i riskut dhe roli i risigurimit;
3. Vlerësimi i provigjoneve teknike bazuar në standardet e IAIS-it dhe qasja bazuar në bilanc;
4. Mbikëqyrja me fokus makro dhe risku sistemik;
5. Kapitali (Solvency) dhe metodat cilësore dhe sasiore të vlerësimit të riskut të sigurimeve;
6. Mbikëqyrja në nivel grupi dhe bashkëpunimi i rregullatorëve të shteteve ku ushtron aktivitet grupi;
7. Menaxhimi i riskut të korporatave dhe përllogaritja e kapitalit rregullator me qasje riskun;
8. Mësimet e marra nga kriza financiare dhe roli i qeverisjes së korporatave.

Vlerësimi i provigjoneve teknike, bazuar në standardet e IAIS-it dhe qasja bazuar në bilanc, ishte një ndër temat e trajtuara gjatë seminarit

Temat kryesore u prezantuan nga drejtues të nivelit të lartë të FSI-së dhe IAIS-it, si dhe profesionistë të tjerë të fushës. Secila prej temave të trajtuara ndiqej nga një rast studimor, i cili diskutohej dhe prezantohej nga pjesëmarrësit e ndarë në grupe pune. Ndër temat që u analizuan dhe u prezantuan nga pjesëmarrësit ishin:

1. Rast studimor lidhur me kriteret e licencimit të një shoqërie sigurimi;
2. Rast studimor lidhur me mbikëqyrjen e grupit ku u theksuan mjaftueshmëria e kapitalit të grupit, qeverisja e tij dhe menaxhimi i riskut në nivel grupi;
3. Rast studimor mbi identifikimin e hershëm të shoqërive të sigurimit me paqëndrueshmëri financiare dhe analizimin e shkaqeve si pasojë e së cilave një shoqëri sigurimi rrezikon falimentimin.

Në përfundim të seminarit, pjesëmarrësit e organizuar në grupe pune, realizuan një sërë prezantimesh rreth çështjeve të ndryshme të procesit të mbikëqyrjes.

LAJMET NGA RAJONI

Forumi AIIF - Azerbajxhan

www.xprimm.com

Forumi Ndërkombëtar i Sigurimeve i Azerbajxhanit, *AIIF 2013 (Azerbaijanis International Insurance Forum - 2013)* u mbajt në Baku, më 20-21 qershor 2013. Kjo është ngjarja më e rëndësishme për tregjet



e sigurimeve dhe e risigurimeve në Kaukaz e Azinë Qendrore. Aktiviteti u organizua nga Shoqata e Siguruesve të Azerbajxhanit në partneritet me Media XPRIMM dhe me mbështetjen e Ministrisë së Financave të Republikës së Azerbajxhanit.

Gjatë zhvillimit të këtij forumi u diskutuan perspektivat e zhvillimit të industrisë së sigurimeve në rajonin e Kaukazit. Në të morën pjesë mbi 200 përfaqësues të shoqërive të sigurimit e risigurimit të tregjeve rajonale, të tilla si: Azia Qendrore, Evropë, Turqi, Rusi dhe ish republikat sovjetike (*CSI-countries*)

Abu Dhabi

www.xprimm.com

Sipas AIIF 2013, 98% e popullsisë në Abu Dhabi ka sigurim shëndetësor dhe ky është shteti i parë në Emiratet e Bashkuara Arabe që reformoi sistemin publik.



Dita e dytë e *Forumit AIIF 2013*, ju kushtua sigurimit shëndetësor në rajon e lidhur me përvojën ndërkombëtare pas futjes së sigurimit të detyrueshëm shëndetësor në Azerbajxhan. Në kuadër të këtij seksioni, Finn Goldner, këshilltar i lartë i kompanisë së sigurimit për Lindjen e Mesme dhe Afrikën i shoqërisë *MUNICH Health Daman Holding* bëri një prezantim rreth zbatimit të sigurimit shëndetësor të detyrueshëm në Abu Dhabi, si pjesë e reformës së sistemit shëndetësor.

Duhet përmendur fakti se Abu Dhabi është shteti i parë në Emiratet e Bashkuara Arabe që reformoi sistemin publik, sistem i cili më parë ishte kritikuar për mungesën e transparencës përsa i përket mënyrës me të cilën paratë e mbledhura përmes sistemit të sigurimit publik shëndetësor shpenzoheshin si edhe për shkallën e lartë të pagesave informale.

Këshilltari Finn Goldner në prezantimin e mbajtur në *AIIF 2013* theksoi se synimi ishte të ndërtonim një skemë efikase transparente bazuar në tre objektiva:

- Futjen e një sistemi të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor për absolutisht të gjithë, pavarësisht të ardhurave;
- Krijimin e një organi rregullator të dedikuar kësaj fushe;
- Shpalosjen e tërë projektit përmes një sistemi të bazuar në një partneritet publik-privat në të cilin shteti luan një rol.

Sipas këshilltarit Goldner skema nuk përjashtonte përfshirjen e qeverisë. Ai theksoi se skema e detyrueshme përfshin tri lloje produktesh të përshtatura për klasifikime të ndryshme të klientëve:

- Një policë bazë, e paguar nga punëdhënësi për ata me të ardhura minimale;

98% e popullsisë në Abu Dhabi ka sigurim shëndetësor dhe ky është shteti i parë në Emiratet e Bashkuara Arabe që reformoi sistemin publik.

- Një policë për mbulim-mesatar, për atë klasë punonjësish (kryesisht të huaj) të administratës me të ardhura të nivelit të mesëm që jetojnë në Abu Dhabi, ("white-collar employees");
- Një policë maksimale për ata banorë vendas (me të ardhura të larta, të cilët përfaqësojnë vetëm 20% të popullsisë).

Kjo reformë mund të sintetizohet vetëm përmes një treguesi: 98% e popullsisë në Abu Dhabi tani ka sigurim shëndetësor.

Turqi

www.xprimm.com

Sistemi publik i sigurimit shëndetësor turk po përballet me probleme të ngjashme me ato të vendeve të tjera, të tilla si mbipopullimi i spitaleve publike. Kjo është arsyeja pse autoritetet po nguten për të krijuar një sistem privat. Menekse Ucaroglu, Presidente e Bordit të Marrjes në Sigurim të Stambollit deklaroi gjatë Forumit AIF-2013, se në maj filluan diskutimet lidhur me ngritjen e një kornize të bashkëpunimit ndërmjet disa institucioneve si Autoriteti i Mbikëqyrjes së Sigurimeve, Thesari, kompanive të sigurimit, si dhe kompanitë private të sektorit të mjekësisë.



E rëndësishme është të theksohet se autoritetet turke janë përgatitur tashmë për reformën e sistemit shëndetësor. Vendi aktualisht ka ngritur një qendër informative, SAGMER, e cila menaxhon dhe operon një bazë të dhënash në mënyrë që të parandalojë përpjekjet për mashtrim, për të shmangur policat e dyfishta të sigurimit, dhe për të mbledhur të gjitha informatat në lidhje me sigurimin shëndetësor privat.

Ndërsa pritët për reformën e sistemit shëndetësor në vend, aktualisht, rreth 2,5 milion turq kanë një policë të sigurimit shëndetësor privat. Gjatë dy viteve të fundit, sipas Menekshe Ucaroglu, Presidente e Bordit të Marrjes në Sigurim të Stambollit, tregu i sigurimit shëndetësor njohu rritje me rreth 10-15%. Ky treg ka 23 sigurues, të cilat janë autorizuar të ofrojnë sigurim shëndetësor privat, ndër të cilat tre të parët dominojnë pothuajse gjysmën e tregut.

Lituani

www.xprimm.com

Shoqëria më e madhe e sigurimit në Lituani, *Draudimas* ka kryer një anketim On-line lidhur me sigurinë e trafikut dhe rolin e edukimit kulturor. Sipas anketim, ku morën pjesë 10,000 pjesëmarrës, pavarësisht nga mosha apo përvoja në dhënien e makinës, më shumë se gjysma e shoferëve të Lituanisë besojnë se edukimi dhe rritja kulturore në dhënien e makinës do të përmirësojë sigurinë e trafikut më shumë se dënimet

Aktualisht, rreth 2,5 milion turq kanë një policë të sigurimit shëndetësor privat

e repta për shkelje të rregullave të trafikut rrugor ose rritja e numrit të madh të policëve të patrullimit. Informacion u përcoll nga mediat lituaneze (Leta / ELTA).

Megjithatë, realiteti nuk përputhet me gjykimin e shoferëve për sjelljen e tyre. Sondazhet dhe ekspertët e trafikut thonë se gjolat e mëdha dhe patrullat e policisë në rrugë, inkurajojnë shoferët për të ndjekur rregullat e qarkullimit.



“Studimi ynë tregoi se shoferët mendojnë se siguria në rrugë do të përmirësohet më shumë në qoftë se i kushtohet vëmendje më e madhe trajnimit kulturor të shoferëve. Rreth 57% e të intervistuarve mbështetën një mendim të tillë”, u shpreh për media lituanese, shefi i departamentit të sigurimeve të shoqërisë “Draudimas”.

Slovaki

www.xprimm.com

Kompanitë slovake të sigurimeve po mbështeten gjithnjë e më shumë në shërbimet e detektivëve privatë për të zbuluar mashtrimin në sigurime shëndetësore. Ky ishte një raportim nga gazeta “Pravda” në fund të qershorit. Detektivët privatë janë të detyruar të marrin licenca të veçanta. Po kështu ka edhe disa rregulla për çfarë ata janë të lejuar të survejojnë dhe çfarë lloj informacioni mund të marrin. Ata nuk janë të lejuar të shqyrtojnë bindjet politike apo fetare të një personi, si dhe gjendjen shëndetësore të tij.



Edukimi dhe rritja kulturore në dhënien e makinës do të përmirësojë sigurinë e trafikut më shumë se dënimet e repta për shkelje të rregullave të trafikut rrugor.

Kompanitë slovake të sigurimeve po mbështeten gjithnjë e më shumë në shërbimet e detektivëve privatë për të zbuluar mashtrimin në sigurime shëndetësore

Për këtë numër punuan:

R. Guri, D. Kalaja, R. Eltari, Dh. Hazbiu,
E. Beqir-Aga, E. Kokona